


LESHNICA SH.P.K

PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE

SHFRYTËZIM KROMI ME MINIERË NËNTOKËSORE



TE DHENA TE PERGJITHSHME PER SHOQERINE;

Kompania “ LESHNICA “ Sh.p.k është krijuar që në vitin 1998 e regjistruar në vitin 2006 në QKR me nr. K67617205B Nipti si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Në pak vite arriti një zhvillim të dukshëm si rezultat i futjes së teknologjisë bashkohore që zbatoheshin për herë të parë në Shqipëri.

Kompania “ LESHNICA “ Sh.p.k është e specializuar në :

Fushën e kërkimit, zbulimit dhe shfrytëzimit të mineraleve xeherore, prodhimi dhe tregtimi i tyre brenda dhe jashtë vendit, kryerja e punimeve të kërkimit zbulimit dhe shfrytëzimit të mineraleve, prodhim dhe tregtim të materialeve të ndërtimit, në fushën e transportit të mallrave dhe përdorimi civil i lendeve plasese.

Kompania “LESHNICA“ sh.p.k me Adresë të zyrës qendrore ” Lagjja Kapit, Rruga Nacionale Kukës-Surroj Km 30, KUKËS” kërkon të pajiset me Leje Mjedisore dhe të nënshtrohet procedurave për VNM paraprake siç parashikohet në ligjin nr. 10440, datë 7.07.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, **per aktivitetin e shfrytëzimit të kromit me miniere nentokesore** referuar lejes minerare të shfrytëzimit Nr.459, date: 26.03.1999. Objekti i shfrytëzimit ndodhet në qarkun Kukës, Bashkia Kukës , Fshati Surroj, vendburimi i quajtur ”Leshnicë”.

Ky subjekt, paraqitet në cilësinë e subjektit investitor të punimeve të hapjes të një miniere nentokesore për shfrytëzimin e kromit, të ndodhur në qarkun Kukës, Fshati Surroj, vendburimi i quajtur ”Leshnica”. Objekti i vlerësimit të këtij raporti është projekti për hapjen e një miniere nentokesore për shfrytëzimin e kromit. Kjo miniere nentokesore për shfrytëzimin e kromit do të shërbejë për nxjerrjen e mineralit të kromit , me qëllim rritjen e sasisë së kromit të dalë nga kjo zonë minerare dhe plotësimin e nevojave të tregut vendas dhe të huaj me këto minerale të dobishme. Ky raport paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, parashikon ndikimet në mjedis nga punimet e ndërtimit dhe hapjes së minierës dhe të infrastrukturës perkatese, si rrugë, energji elektrike, ujë, etj. Sipërfaqja totale e kërkuar nga investitori është $S=0.015 \text{ km}^2$.

Për aktivitetin që kryen, Kompania është e pajisur me të gjithë dokumentacionin e duhur tekniko-ligjor perkates për aktivitetin e shfrytëzimit të kromit me miniere nentokesore. Lidhur me marrëdhëniet me institucionin e mjedisit, shoqëria kërkon t’i nënshtrohet procedurave të Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis për fazën e ndërtimit dhe punimeve të hapjes së minierës nentokesore dhe me mbas të pajiset me Leje Mjedisore dhe të kryejë procedurat e konsultimit me publikun siç parashikohet në legjislacionin perkates. Për këto qëllime aktiviteti ka hartuar përmbledhjen jo teknike si më poshtë;

MENYRA E HAPJES SE VENDBURIMIT LESHNICA

Hapja e vendburimit të Leshnices do të kryhet me traverbang dhe është menyra më e thjeshtë e cila përdoret kur relievi i vendburimit e favorizon një gjë të tillë. Kjo menyre siguron shfrytëzimin ekonomik të vendburimit, transport me rendiment të lartë dhe ndërtim sipërfaqësor të thjeshtë. Në raport me relievin e sipërfaqes traverbangu do të hapet kryq ose diagonal me shtresat, duke përshkuar të gjithë shkëmbinjtë që ndodhen mbi ose në anë. Në zgjedhjen e vendit të hapjes së traverbangut janë marrë në konsideratë: Oborri i traverbangut të jetë një sheh i mjaftueshëm për vendosjen e objekteve tekniko – administrative me shpenzime sa më minimale dhe i mjaftueshëm për depozitimin e mineralit dhe sterilit. Sheshi dhe hyrja e traverbangut të jetë sa më afër rrugëve automobilistike, linjave elektrike etj.. Hyrja e traverbangut të zgjidhet e tillë që të menjaherë rreziku i shkarjes së tokës dhe i përmbajtjes nga ujrat Gjatësia e traverbangut të jetë sa më minimale dhe rezervat me të mëdha të vendburimit të ndodhen mbi nivelin e traverbangut kryesor

Perparësitë e hapjes me traverbang në krahasim me menyrat e tjera janë :

- Hapja e vendburimit realizohet në kohë më të shkurtër dhe punimi takon direkt shtresën e dobishme
- Skema teknologjike e sheshit industrial është më e thjeshtë si në ndërtim ashtu edhe në shfrytëzim
- Shpenzimet për ndërtimin e minierës janë minimale, pasi vëllimi i punimeve është i vogël
- Kosto e 1 ml punim është shumë më e ulët se 1 ml pus apo dishenteri
- Shpenzimet e transportit në traverbang janë minimale
- Siguron kalim të pakufizuar të njerezve pa penguar transportin dhe furnizimin
- Kosto e shpenzimeve të ajrimit është e ulët

Për hapjen e këtij objekti janë projektuar dy traverbang të cilët do të shërbejnë për hapjen përgatitjen dhe shfrytëzimin e rezervave të këtij objekti dhe do të shërbejnë një perspektive me afat gjatë, pasi sipas të dhënave nga grupi i studimit fusha minerare është me perspektive në rritje, në vecanti në drejtim të veriperëndimit dhe i verilindjes. Me hapjen e dy traverbangeve është projektuar që fusha minerare e përcaktuar nga të dhënat e shpimeve të kryera në këtë objekt të ndahet në dy kate. Kati i parë, horizonti + 780 deri në sipërfaqe, zona midis profileve 0 – II, dhe kati i dytë, horizonti + 740 - + 780, zona midis profileve II – III. Krahas funksionit të hapjes dhe përgatitjes të rezervave të dhëna për shfrytëzim do të shërbejnë edhe për kërkim zbulim dhe zonalizim të cilën ato hapen, duke sqaruar kështu mundësinë e ekzistencës së trupave apo linzave paralele. Disnivelet ndërmjet dy traverbangeve është projektuar 40 m, kjo për të favorizuar hapjen dhe përgatitjen e fushës minerare në katë 40 m.

Gryka e traverbangut

Hydratimi i traverbangut përfaqëson grykën e tij e cila përfaqëson pjesën e traverbangut që kalon në aluvione dhe trungu që kalon në shkëmbinjtë masiv të zonës ku hapet. Goja dhe gryka e traverbangut armatosen me materiale rezistent kundrejt zjarrit. Në rastin konkret të dy hydratimi të traverbangut do të betonohen. Volumi i punës për hapjen e grykave të traverbangut varet nga relievi ku ato do të hapen.

Rrezimi i masivit

Bazuar në të dhënat eksperimentale shpimi birave realizohet 5 min për një m l birë. Mbushja e birave është 16 minuta. Për 10 bira me thellesë 1.5 m, plasja + ajrimi do të 25 – 30 minuta. Kontrolli i frontit me lehtësi = 20 – 30 min, ngarkimi dhe transporti i shkëmbit me krahe (2 punëtorë) = 15 për 1 vagon (varet nga gjatësia e punimit. Vendosja e armatës prej druri

180 min (1 kuadro), vendosja e armatures se betonit ne distance 1 m linera = 16 ore (4 punetore).

Ngarkimi i materialit

Eshte proces i veshtire dhe ze rreth 40 – 50 % te kohes se pergjithshme te nje cikli.

Ai mund te jete me dore ose i mekanizuar. Para ngarkimit te shkembit ne vagon ai afrohet, ricotehet, shkriferohet dhe pastaj ngarkohet. Ne ngarkimi me dore perdoret lopata. Vagoni afrohet prane ballit duke perdorur shina te shkurtera te levizshme. Para shperthimit te minave ne dysHEME te ballit te punimit shtrohen flete llamarine per te lehtesuar ngarkimin me lopate, rritjen e rendimentit ne masen 20 – 30 %. Kazma perdoret per shkriferimin e shkembit, ben pastrimin e faqeve te punimit nga copat e varura dhe sherben per hapjen e kanalit te kullimit te ujrave. Ngarkimi i mekanizuar mund te realizohet me skreper ose lopate vetengarkuese, e cila ecen dhe punon neper shinat e zakonshme qe ka punimi minerar, me energji elektrike ose pneumatike. Kapaciteti i koves 0.15 – 0.20 m³. Rendimenti i ngarkimit 15 – 20 m³ ore me kend rrotulli 30- 45 ne te dy krahet

Punimet ndihmese

Pas pastrimit te ballit kryhen punime ndihmese si shtruarja e shinave te perhereshme, hapja e kanalit te ujit, vendosja e tubove dhe kabllove te ndryshem ne dysHEME. Tubot, kavot etj.. duhet te varen ne menyre te tille ne faqet e punimit qe te mos demtohen nga levizja e mekanizmave ose vagonave.

Shtrimi i rruges se sinave perfshin keto operacione ; rrafshohet dysHEMEja e punimi, shtrohet shtresa e zhavorit apo cakullit, vendosen traversat dhe shinat. Tipai i shinave zgjidhet nga pesha e tyre, kg / ml dhe ne varesi te ngarkese qe transportohet mbi to dhe shpejtesia e mjeteve te transportit. Distanca ndermjet traversave 0.6 – 0.8 m. ne lidhjet e shinave kjo distance merret me e vogel. Gjatesia e traversave 1200 – 1600 mm, lidhja me shinat behet me gozhde. Shinat mes tyre lidhen me ngastra. Skajet e shinave qe lidhen duhet te jene ne nje nivel per te menjanuar lekundjet dhe goditjet e vagonit. Shinat ne lidhje kane nje largesi 2 mm, efekti i ndyshimit te temperatures. Shtresa nen traverse eshte zhavorr ose cakull i forte me trashesi jo me te vogel se 10 cm. Heqja e ujrave sigurohet ne punimet minerare nga kanalet qe ndertohen ne dysHEMENE e tyre. Pjerresia e kanalit e barabarte me ate te shinave 3 – 5 %. kanalet ne shkembenj jo te qendrueshem perforcohen me armature. Zakonisht ato mbulohen per tu mbrojtur nga papastertite dhe njekohesisht perdoren per kalimin e njerezve. Shpejteia e rrjedhes se ujit neper kanal duhet te 0.25 – 0.30 m/s, ndersa shpejtesia maksimale 4.5 m/s.

Armatimi

Hapja e traverbangut parashikohet te kryhet pa armatim. Armatimi do te perdoret vetem ne zonat tektonike ose shtresa me qendrueshmeri te vogel. Armatura prej druri ka avantazhe ne krahasim me armaturat e tjera, pasi pergatitet dhe transportihet lehte. Vendosja e saj eshte e thjeshte dhe harxhon me pak kohe se armaturat e tjera, eshte sinjalizuese dhe punon mire ne prkulje ose shtypje aksiale. Si rregull afati i perdorimit eshte 1 – 3 vjet. Konstruksioni kryesor i kesaj armature eshte seksioni drejtekendesh ose trapez. Ne rastin konkret kuadrot e armatimit aty ku do te perdoren do te jene kryesisht jo te plote dhe perbehen nga kapela dhe 2 kembet. Kembet e kuadrit ne forme trapezi formojne me dysHEMENE e punimit nje kend 80 – 85 °. Kuadrot vendosen pingul ne aksin gjatesot te punimit. Elementet e armatures pergatiten nga shtylla te rrumbullakta, permasat e te cilave varen nga fortesia e shkembenjve. Largesia ndermjet kuadrove percaktohet nga fortesia dhe qendrueshmeria e shkembenjve. Ne shkembenj te paqendrueshem ato vendosen te puthitura me njera – tjetren , ne ato me fortesi

mesatare 0.5 – 0.8 m dhe ne shkembjen te forte 0.8 – 1.2m larg nga njeri – tjetri. Kur ne dyshemene e punimit shkembjenjte jane te dobet, kuadrit i shohet edhe nje element i dyshemese mbi te cilin mbeshteten kembet e armatures. Ne kete rast kuadri quhet i plote. Kuadri ne tavan dhe anash vishet me garniture e cila nuk lejon rrezimin e gureve nga tavani dhe mundeson shperndarjen uniforme te presioneve. Lidhja e kapeles me kembet eshte e ndryshme. Zgjidhet me e pershtateshmja duke u nisur nga kushtet konkrete te vendosjes. Ngritja e armatures prej druri realizohet sipas pasaportes se realizuar per kete qellim. Ne fillim pergatitet vendi ku do te vendoset armatura sipas permasave te punimit. Hapen ne dysheme folete ku do te vendosen kembet e armatures me thellesi 5 – 20 cm dhe diameter sa i kembes se armatures. Hapja behet me cekic rrezues ose me kazem e lopate. Armatura si rregull pergatitet ne siperfaqe. Ngritja fillon me vendosjen e kembes ne fole. Mbajtja e tyre nepozicionin e duhur behet me sfurqe metalik ose duku i lidhur ato me armaturen ekzistuese. Drejtimi i kuadrit pasi vendoset kapela kontrollohet me plumbce, pas kesaj behet perforcimi i kuadrit ne faqet e punimit me pyka druri ne dy qoshet e siperme. Perseri behet kontrolli me plumbce. Drejtimi ndaj aksit et punimit realizohet me 3 plumbce.

NDERTIMET SIPERFAQESORE

Per sasine e rezervave te zbuluara nga te cilat te nxjerreshme 40.000 ton nuk parashikohen ndertime siperfaqesore. Ne afersi te hyrjes se dy traverbangeve do te instalohen dy konteniere per zyra, magazine etj.

Rruge, sheshe, sistemime

Grykat e traverbangeve qe do te hapen jane te lidhura me rruge auto. Kerkohet vetem permiresimi i tyre. Ne afersi te hyrjeve do te ndertohet oborri i traverbangut me sheshet e depozitimit te mineralit dhe sterilit. Depozitimi i sterileve do te behet ne dalje te traverbangut + 740 dhe + 780. Sheshi i depozitimit te traverbangut + 740 do te kete nje siperfaqe prej 1700 m². Kuota e siperme e sheshit eshte + 740 m dhe kuota e poshteme + 730 m. Kapaciteti mbajtes i ketij sheshi eshte me i larte se ai i llogaritur. Sheshi i depozitimit i traverbangut + 780 do te kete nje siperfaqe prej 1200 m². Kuota e siperme e sheshit eshte + 780 m dhe kuota e poshteme + 772 m. Kapaciteti mbajtes i ketij sheshi eshte me i larte se ai i llogaritur.

BAZA MEKANIKE

Per hapjen pergatitjen dhe shfrytëzimin e kesaj miniere jane parashikuar keto makineri :

Emertimi	Mjesia	Sasia
Elektrokompresor 10 m ³ , 75kw	Cope	1
Ventilator kinez 11 kw	Cope	2
Cekic shpues me kollone, kinez 7655	Cope	2
Elektrosaldatrice	Cope	1
Tub ajrimi 400 mm	MI	582
Tube i gomuar ajrimi	MI	20
Mjet ngarkimi	Cope	1
Kontenier	Cope	2
Vagova veteshkarkues	Cope	2
Bromina 1,6, suedeze	Cope	2
Gur fresibel	Cope	2
SHUMA MAKINERI		

ZGJEDHJA E SISTEMIT TË SHFRYTËZIMIT

Për të vendosur sistemin më të përshtatshëm të shfrytëzimit është e nevojshme të krahasojmë parametrat që sigurojnë ata në përputhje me kushtet specifike që ka mekanika shkëmbore e vb Leshnice dhe synimet e investitorit për përmbushjen sa më të mirë të kërkesave të koncesionit.

Sistemet e shfrytëzimit që mund të përdoren janë :

Sistemi i shfrytëzimit me galeri nënkati

Përveç sistemit me galeri nënkati rekomandojmë :

- Sistemin e shfrytëzimit me dhoma e kollona. Transporti brenda dhomes me skreper.
- Sistemi i shfrytëzimit me mbushje nga poshtë-lartë
- Sistemi i shfrytëzimit me mbushje nga lartë- poshtë:

Pasi kemi bërë analizen e tyre bazuar edhe në pervojën e deri tanishme të zonës minerare Leshnice kemi zgjedhur;

Sistemin e shfrytëzimit me galeri nënkati.

Sipas këtij sistemi fusha minerare ndahet në kate e cila në shtrirje, kufizohet nga remontet ose furnelet, ndërsa në rënie nga galeria e ajrimit dhe e transportit. Sistemi i shfrytëzimit me galeri nënkati me hapësira të hapura është aplikuar me sukses për trupat me pjerrësi mbi 45°, me gjatësi të blloqeve 20 – 50 m, lartësi të katit në funksion të tektonikave dhe trashësisë deri në 40 m dhe lartësi të nenkateve 6 – 8 m. Galeria e transportit krahas shfrytëzimit kryen transportin dhe ajrimin e punimeve të shfrytëzimit. Në përfundim ato braktisen. Katet si rregull shfrytëzohen nga lart – poshtë, mënyrë e cila ka si përparësi ruajtjen e drejtimit të rrymës së ajrit në ngjitje si edhe faktin që remontet nëpër të cilat bëhet kalimi i njerezve, ndoshen gjithmone në masivë dhe paprekur. Shfrytëzimi do të realizohet nga kufiri në qendër. Sipas kësaj mënyre nga kufiri në qendër njihet me mirë kushtet gjeologjike – minerare dhe teknike – minerare dhe nuk lejon kolonën për ruajtjen e galerive dhe hapësirat e shfrytëzimit. Kryerja e punimeve përgatitore prerëse dhe atyre të shfrytëzimit bëhet në mënyrë të programuar dhe të harmonizuar. Siç trajtohet edhe në pasaportën e shfrytëzimit ndarja e blloqeve do të realizohet me punime të pjerrëta furnele ose remonte me pjerrësi 60 – 70°. Në galerinë e transportit në cdo 6 – 8 m ndërtohen grykat e ngarkimit të mineralit. Llojet e konstruksionit të grykave të ngarkimit do të varen nga sasia e mineralit që parashikohet të kalojë në njësinë e kohës dhe jetëgjatësia e saj, përmasat e galerisë së transportit, armatimi i saj, shkalla e copetimit të mineralit etj. Grykat e ngarkimit ndërtohen të thjeshta dhe të qëndrueshme. Duhet të jenë të sigurta në punë pasi blloqet e mëdha shpesh herë vështirojnë teknologjinë e nxjerrjes së mineralit duke bllokuar furnelet dhe grykat e rrjedhjes. Menjanimi i bllokimeve bëhet me leva të gjata ose me lende plasese. Gjate këtij procesi duhet të zbatohen rigorozisht rregullat e sigurimit teknik. Ngacmimi me leva bëhet me kujdes duke siguruar punëtorin në vende të lira dhe të ndricuara në mënyrë të tillë që punëtori që merret me zhblokimin në cdo rast të largohet menjëherë. Kategorikisht ndalohet vajtja e zjarrmetarit në grykë ose në copërat e mineralit të varur që ka bllokuar atë. Copat e mëdha mund të copëtohen mbi grilen e cila është vendosur mbi grykë. Në këtë rast minatori lidhet me rrip sigurimi. Grilat që mbulojnë grykat e rrjedhjes së mineralit duhet të jenë gjithmone të rregullta për të menjanuar rënie dhe punëtoreve. Nuk lejohet që grilat të mbulojnë me copa minerali në mënyrë të tillë që të lejohet armatura e grykave duhet të jetë sa më e qëndrueshme dhe gjendja e saj duhet të kontrollohet cdo turn. Për ruajtjen e galerisë së transportit dhe të ajrimit mbi dhe në galeritë e katit vihen kolona provizore për mbrojtjen e punimeve përgatitore. Kolonave mbi galerinë e transportit u jepet forma e hinkave për rrjedhjen e mineralit në grykat e ngarkimit.

Sistemi i shfrytëzimit me galeri nënkati me hapësira të hapura për trupat me pjerrësi më të madhe se 45°, me gjatësi të blloqeve 20-50 metra, lartësi të katit në funksion të tektonikave dhe trashësisë deri në 40 metra dhe me lartësi të nënkateve 5-8 metra.

Punimet kryesore të hapjes, gjatesia, seksioni, armatimi

Nr.	Lloji I punimit	Njesia matese	gjatesia totale	Seksioni I punimit
1	Galeria + 740	ml	381	5,2 m ²
2	Horizonti + 740 djathtas	ml	19,6	5,2 m ²
3	Horizonti + 740 majtas	ml	70,2	5,2 m ²
4	Galeria + 780	ml	224	5,2 m ²
5	Horizonti + 780 djathtas	ml	44,2	5,2 m ²
6	Horizonti + 780 majtas	ml	103,7	5,2 m ²
	Remontet +780 - sipërfaqe	ml		
7	R 4	ml	53,5	3,6 m ²
8	R 5	ml	52,9	3,6 m ²
	Remontet +740 - + 780	ml		
9	R 1	ml	48,2	3,6 m ²
10	R 2	ml	46,5	
11	R 3	ml	45,6	3,6 m ²
	PUNIME KAPITALE	ml	605	5,2 m ²
	PUNIME PERGATITORE KATI	ml	237,7	5,2 m ²
	REMONTE KONTURUES BLOKU		246,7	3,6 m ²
	TOTAL	ml	1089.4	

Seksionet e punimeve

Punimet minerare kryesisht kalojnë në shkembjen që përfaqsohen nga dunitet, peridotitet e serpentinitet me fortësi që luhatet nga VI – VIII, ndërsa punimet që hapen në kromite me fortësi VI – VII, janë me qëndrueshmeri mesatare deri në të lartë. Kushtet tekniko – minerare të hapjes së punimeve janë të favorshme. Seksionet e punimeve të hapjes dhe të përgatitjes zbatohen sipas tipeve që iu janë pershtatur kushteve teknike të këtij v.b. dhe që kryejnë funksionet e tyre në varesi të sistemit të shfrytëzimit, qëllimit të hapjes llojit të transportit dhe afatit të shërbimit. Punimet horizontale dhe remontet do të kenë formë qemerore, ndërsa furnelet formë katrorë ose drethkëndeshë. Seksioni i punimeve të hapjes, traverbangeve dhe niveleve kryesore të hapjes do të jenë 5.2 m². Seksioni i punimeve të nënkateve 3.6 m². Remontet dhe furnelet do të jenë me seksion 1.2 x 2.6 (3.12 m²), peroren dhe seksione 1.2 x 1.2, 1.5 x 1.5, 1.5 x 2.4 etj.. Furnelet dhe remontet do të jenë me dy ndarje të veshur me derrasa nga ana e depozitimit të mineralit dhe të pajisura me shkallë nga ana e levizjes së punonjesve. Armatimi i tyre do të jetë druri me kuadro të puthitura me dimensione 16 – 22 cm.

IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS**Lloji i ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jo direkte)**

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi “Ndotësi paguan”
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe ne perputhje me kerkesat e VKM Nr. 686, date 29.07.2015 “Per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis” dhe ka si synim idnetifikimin, vleresimin dhe parandalimin e ndotjes se mjedisit, me qellim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera
- b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- e) Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- f) Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
- g) Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.

Ndikime te rendesishme gjate punimeve te ndertimit dhe hapjes se minieres. (Per fazen e funksionimit, do te kryhet vleresim i detajuar i ndikimeve ne mjedis dhe do te pajiset me leje mjedisore te tipit B.)

NDIKIMET NË AJËR

Në fazën ndërtimore të projektit të “ Miniere nentokesore per shfrytezimin e kromit” aktivitetet që do të realizohen në këtë fazë janë përgatitja e sheshit në të cilin do të instalohet paisjet, ndërtimit të rezervuarit dekantues dhe ndërtimi i të gjithave objekteve ndihmëse. Nga këto aktivitete që do të realizohen në këtë fazë do të shkaktohen dhe do të emetohen gaze të cilat përftohen nga djegia e brendëshme e lëndëve djegëse në motorët e automjeteve dhe mjeteve që do të përdoren në fazën ndërtimore të projektit. Për shkak të përmasave të vogla të punimeve që do kryhen gjatë fazës ndërtimore dhe kohëzgjatjes së shkurtër së kryerjes së

këtyre punimeve ky ndikim konsiderohet që do të jetë i niveleve të vogla pothuajse i pa i konsiderueshëm dhe afat-shkurtër. Gazet të cilat emetohen në ajër ndikojnë në cilësinë e ajrit dhe në mikroklimë. Aktivitetet që do të zhvillohen gjatë fazës ndërtimore do të emtojnë gaze të cilat janë të llojeve pas procesit të djegies të karburantit. CO₂ është i vetmi gaz që përftohet gjatë lëvizjes sëautomjeteve dhe fuksionimit të mjeteve të ndryshme i cili përfshihet në grupin e gazeveserë të percaktuar në Protokollin e Kiotos. Niveli i këtij gazi nuk do të jetë i lartë dhe nukndikon në cilësinë e ajrit dhe ne mikroklimë.

NDIKIMET NË CILËSINË E TOKËS

Për vlerësimin e ndikimeve që mund të shkaktohen gjatë gjithë fazës ndërtimore të projektit u morën parasysh faktorët e mëposhtëm:

- Karakteristikat gjeokimike dhe karakteristikat fizike
- Ndotja e tokës
- Procesi i heqjes së shtresës sipërfaqësore të dheut në territorin e projektit

Gjatë punimeve që do të realizohen gjatë fazës ndërtimore do të ndikohen karakteristikat gjeokimike dhe ato fizike të sipërfaqes së territorit për shkak të largimit dhe të grumbullimit të përkohshëm të shtresave të dheut gjatë përgatitjes së terrenit për instalimin e pajisjeve. Një lloj ndikimi të ndotjes së tokës do të jetë në raste kur mund të ndodhin derdhje aksidentale të hidrokurbureve që do të përdoren si lëndë djegëse. Këto ndikime të cilat do të ushtrohen mbi karakteristikat e tokës do të jenë të llojit negativ por të përkohshme. Gjithashtu këto ndikime karakterizohen si të kthyeshme sepse gjatë fazës së rehabilitimit pas mbylljes së operimit të minieres të kromit do të eliminohen duke mbuluar të gjitha territoret e ndikuara me dhe pjellor dhe i pasur me lëndë organike duke krijuar kushte normale për zhvillimin e bimësisë. Gjatë fazës operuese të gjithë faktorët e lart përmendur për një cilësi tokë të mirë do të ndikohen gjatë kësaj faze. Në sipërfaqen e tokës do të rritet ndikimi negativ, por ky ndikim negativ do të këtë jetë gjatësi aq sa do të jetë edhe jetëgjatësia e projektit. Gjithashtu duke zbatuar edhe masat zbutëse ky lloj ndikimi do të reduktohet. Gjithashtu ky lloj ndikimi vlerësohet si i kthyeshëm pas zbatimit të masave rehabilituese pas mbylljes së projekti

NDIKIME NË UJERAT SIPËRFAQËSORE DHE NËNTOKËSORË

Gjatë fazës ndërtimore aktivitetet që do të realizohen nuk do të ndikojnë në ujrat sipërfaqësore dhe nëntokësore. Natyra e aktiviteteve do të jenë përgatitja e pajisjeve për hapjen e galerise, sheshit për instalimin e pjesjeve, ndertimi i objekteve ndihmëse dhe rezervuari i dekantimit. Gjatë këtyre aktiviteteve nuk përdoret ujë dhe nuk shkarkojnë ujë në mjedis dhe në ujrat sipërfaqësore të zonës. Si rrjedhojë rezulton që gjatë fazës ndërtimore ujrat sipërfaqësore dhe nëntokësore nuk do të ndikohen. Ndërsa gjatë fazës operuese të minieres është e nevojshme përdorimi i ujit gjatë procesit të shfrytëzimit për franksionimin dhe thyerjen e materialit. Gjatë procesit teknologjik është e nevojshëm uji të cilin kompania do ta sigurojë duke ricikluar ujin që del nga galleria dhe nga burimet e zones. Sasia e ujit që do të përdoret gjatë një procesi të plotë teknologjik do të ripërdoret përsëri por para se ai të ripërdoret do të trajtohet të rezervuarin e dekantimit. Parimi i rezervuarit të dekantimit është pastrimi i ujit nga llumrat e përfuara gjatë procesit. Kjo procedure e përdorimit të ujit do të ripërsëritet deri në ato nivele ku përftohet një sasi e konsiderueshme dhe e pastër e ujit. Sasis e

ujit të përdorur gjatë procesit të pasurimit të kromit kur cilësohet si e papërdorshme nuk do të shkarkohet në ujrat sipërfaqësore të zonë apo në mjedis por do të depozitohet në rezervuarin e ujrave teknologjike i cili ndodhet brenda territorit të minieres. Për çdo rast, përpara çdo shkarkimi, ujrata e trajtuara në dampat do të analizohen konform parametrave për ujrat e shkarkimit sipas VKM Nr.177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”. Në afërsi të vëndëndodhjes ku është parashikuar të hapet galeria e minieres ndodhet perroi i Leshnices. Duke u bazuar në procesin teknologjik në ujrat e basenit nuk parashikohet që do të shkarkohen ujra të ndotur. Për këte arsye kompania operuese parashikon në projektin teknik ndërtimin e rezervuarit për mbledhjen e ujrave industriale. Meqënëse minerali në vetvete përmban Cr_2O_3 i cili nuk është i tretshëm në mjedis ujor, dhe pH neutral, ujrata e shkarkimit nuk janë të kontaminuara. Përsa i përket ujrave të rreshjeve, ato do të sistemohen në kanalet përreth duke penguar marrjen e materialit dhe humbjen e tij. Ndotja e ujrave me substance minerale Cr_2O_3 është pothuajse i pa mundur mbasi dihet që në kushte natyrore Cr_2O_3 nuk tretet në ujë praktikisht e patretshme. Në raste shirash ato do të kenë vetëm permabjtje llumrash të cilat në rrjedhat e poshteme do të dekantohen gradualisht.

Rekomandime

Me qëllim që subjekti të menaxhojë, reduktojë apo parandalojë ndikimet të cilat vijnë nga ndërtimi dhe funksionimi i instalimit rekomandojmë të aplikohen këto masa:

1. Subjekti të zbatojë të gjitha masat e vendosura në raportin e vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis.
2. Gjatë procesit të ndërtimit dhe hapjes së minieres subjekti të bëjë izolim ose betonim të sheshit të objektit, me qëllim që të parandalojë përhapjen e materialit në tokë dhe ujë.
3. Subjekti të jetë bashkëpunues me komunitetin dhe të gjitha institucionet për mbrojtjen e mjedisit.
4. Subjekti të njoftojë menjëherë institucionet përkatëse në rast avarish me pasojëndotjen e mjedisit.

ADMINISTRATOR

Ahmet VATA

